



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .02.2022

VENDIM

Nr. 69, datë 23.02.2022

PËR

**MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT
DISIPLINOR PËR VITIN 2021”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit Disiplinor,


V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor për vitin 2021”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

2021



**MBI
VEPRIMTARIN
Ë E
KOMISIONIT
DISIPLINOR**

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
KUADRI LIGJOR DHE ZBATIMI I TIJ.....	3
PROCEDURAT DISIPLINORE.....	4
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË SI DHE ORGANET E RIVLERËSIMIT.....	6
PËRFUNDIMET.....	6

I. HYRJE

Komisioni Disiplinor, si një ndër katër Komisionet e Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përgjatë vitit 2021 ka përbushur, me përgjegjshmërinë më të lartë, të gjitha detyrat e tij, që burojnë nga aktet rregullatore ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Referuar nenit 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor*”, të ndryshuar, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, kontributi i Komisionit Disiplinor, ka qenë i drejtuar në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit të tyre, në përbushje të misionit që Këshilli ka, në kuadër të qeverisjes, mbarëvajtjes dhe mirë-administrimit të sistemit gjyqësor.

Verifikimi i shkeljeve disiplinore dhe fillimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve, është një kompetencë dhe përgjegjësi që Kushtetuta dhe Ligji nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, ia ka ngarkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Si e tillë, veprimtaria e Komisionit Disiplinor është e ndërvarur nga veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose subjekteve të tjera pjesëmarrëse sipas ligjit.

Viti 2021 shënoi një rritje të ndjeshme të veprimtarisë së Komisionit Disiplinor, si rrjedhojë e fillimit të funksionimit në kushte më optimale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në raport me vitin 2020, vit i cili përkoi dhe me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe fillimin e funksionimit të Zyrës së tij si dhe fillimit të situatës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19.

Në këtë vit të veprimtarisë, në përputhje me kompetencat e parashikuara në mënyrë të posaçme në Ligjin nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, Komisioni Disiplinor dhe Këshilli u përballën me sfida të reja, si në aspektin e administrimit të procedurave disiplinore dhe në vendimmarrjet përkatëse, të cilat ndihmuan dhe diktuan konsolidimin e mëtejshëm të zbatimit të ligjit dhe vendosjes së praktikave referuese për të ardhmen.

Në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 23.12.2021¹, në zbatim të nenit 61, pika 2, shkronja “j” të Ligjit nr. 115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, u vendos ndryshimi i përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Këshillit. Para datës 23.12.2021, në përbërje të Komisionit Disiplinor kanë qenë anëtarët e Këshillit z. Medi Bici, në cilësinë e Kryetarit dhe në cilësinë e anëtarëve z. Dritan Hallunaj dhe z. Maksim Qoku. Aktualisht, në përbërje të Komisionit Disiplinor janë anëtarët e Këshillit:

Znj. Marçela Shehu, Kryetare e Komisionit

¹ Shih vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Nr. 601, datë 23.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.13 datë 18.01.2019 të KLGJ “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”

Z. Maksim Qoku, anëtar
Z. Ridvan Hado, anëtar
Z. Alban Toro, anëtar zëvendësues
Z. Dritan Hallunaj, anëtar zëvendësues.

II. KUADRI LIGJOR DHE ZBATIMI I TIJ

Ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit Disiplinor normohet nga Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Rregullorja “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”².

Duke u nisur nga parimet nga të cilat udhëhiqet procesi i shqyrtimit të një procedimi disiplinor, si dhe garancitë e hollësishtme që i njihen palëve gjatë kësaj procedure, ku përfshihet dhe mundësia që të dëgjohen në seancë dëgjimore dhe të mbrohen, në respektim të parimit të barazisë së mjeteve dhe kontradiktoritetit, del e qartë se Këshilli dhe Komisioni Disiplinor ngarkohen me përgjegjësinë që të ofrojnë garancitë e nevojshme që kërkon e drejta për proces të rregullt ligjor. Këto përcaktime ligjore e transformojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor nga një organ administrativ, në një organ quasi gjyqësor. Si i tillë, gjatë këtij procesi, Këshilli duhet të ndjekë një procedurë quasigjyqësore, e cila në rastin e vendosjes së masave disiplinore, është objekt kontrolli dhe nga një organ kushtetues siç është Kolegji i Posaçëm i Apelit (deri në përfundim të mandatit nëntëvjeçar) apo Gjykata Kushtetuese.

Përgjatë vitit 2021, ndryshimet e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”³, nuk afektuan pjesën që trajton përgjegjësinë disiplinore të magistratëve dhe nuk sollën ndonjë risi në drejtim të praktikës apo ndryshimit të saj.

III. PROCEDURAT DISIPLINORE

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë në kompetencë të tij, Komisioni Disiplinor ka kaluar për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor 10 (dhjetë) procedura disiplinore. Në vijim të procedurave, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i është dhënë fund, me vendim përfundimtar 6 (gjashtë) procedurave disiplinore, nga të cilat 1 (një) procedurë me objekt pezullimin e një magjistrati nga detyra dhe 5 (pesë) procedime disiplinore, të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Konkretisht:

Me vendimin nr. 53, datë 15.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të parashikimeve të neneve 151, pika 1, shkronja “a” dhe 155 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është vendosur pezullimi nga detyra i magjistrates E.H. Procedura administrative është iniciuar kryesisht nga Komisioni Disiplinor, bazuar në informacionin e njoftuar nga Prokuroria e

² Miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, datë 16 Shtator 2020.

³ Amendimi i fundit i këtij ligji i përket Marsit të vitit 2021, miratuar me ligjin nr. 50/2021, datë 23.03.2021.

Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Me vendimin nr. 92, datë 17.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor⁴ është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistrates E.H, bazuar në nenin 140, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kushtet kur u provua se magjistratja në vendimmarrjen e saj ka kryer shkelje shumë të rënda profesionale, duke diskretitur rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

Me vendimin nr. 223, datë 02.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit K.S, bazuar në nenin 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës, i cili rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsionit pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Procedimi disiplinor ka filluar ndaj tre magjistratëve, ku për dy prej tyre Këshilli ka vendosur mbylljen e procedimit. Konkretisht, me vendimin nr. 199/1 dhe nr. 199/2, datë 12.05.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore për ish magjistratët P.Ç dhe P.Dh.

Me vendimin nr. 462, datë 11.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të magjistratit R.H, i cili rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsionit pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

Me vendimin nr. 464, datë 13.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i pjesëshëm i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe vendosja e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistratit H.S, bazuar në nenin 102, pika 2, shkronja “a”, nenin 105, pika 1, shkronja “b”, nenin 107 të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, për zbatim të gabuar dhe të përsëritur të ligjit procedural, të konstatuar nga një gjykatë më e lartë.

Me vendimin nr. 558, datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe vendosja e masës disiplinore të “Uljes së përkohshme të pagës në masën 20 %, për një periudhë prej 6 muajsh” ndaj magjistrates P.H, bazuar në nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, nenin 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe nenin 108 të Ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, për shkelje të rëndë të rregullave të etikës në komunikimin e papërshtatshëm me palët.

⁴ Procedimi disiplinor është filluar në datë 10.12.2020

Në lidhje me 4 (katër) procedimet e tjera disiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka proceduar me dhënien e vendimeve jopërfundimtare, si vijon:

Me vendimin nr. 240, datë 07.06.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor krahas pezullimit nga detyra të gjyqtarës E.K deri në përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj saj, ka disponuar me kërkimin ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kryerjen e hetimeve të mëtejshme në drejtim të shkeljes disiplinore. Mbi ankimin e magjistrates, vendimi është bërë objekt rishikimi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, gjykatë e cila në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vlerësuar të drejtë përfundimin e Këshillit në lidhje me ekzistencën e shkaqeve të marrjes së masës provizore të pezullimit nga detyra.

Me vendimin nr. 463, datë 11.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates E.S, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin është disponuar dhënia e masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”*, bazuar në nenin 58, pika 1 dhe në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

Me vendimin nr. 494, datë 25.10.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratëve P.A dhe N.T, deri në përfundim të procedurës së rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë.

Me vendimin nr. 559, datë 01.12.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për shkak të dhënies së masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”* nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, ka vendosur pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj gjyqtarit R.K, deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

Në lidhje me procedimet disiplinore, aktualisht të pezulluara, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vendimmarrjen e tij, ka vlerësuar se në kushtet kur është konstatuar ekzistenca e një shkakut kushtetues për mbarimin e statusit të magjistratit për subjektet e procedimeve disiplinore, në rrethanat kur ata janë *“Shkarkuar nga detyra”* nga organi disiplinor i rivlerësimit kalimtar dhe çështja e rivlerësimit ndodhet për shqyrtim përpara organit më të lartë të rivlerësimit, një rrethanë e tillë përbën shkak që, bazuar në nenin 145 të Ligjit për Statusin dhe nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, të vendoset pezullimi i shqyrtimit të këtyre procedimeve disiplinore të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi mbajtja ose jo e statusit të magjistratit, në kuptim të Ligjit për Statusin, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor, në kushtet kur shkarkimi nga detyra i magjistratit, përbën një nga rastet e mbylljes së procedimit disiplinor.

IV. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË SI DHE ORGANET E RIVLERËSIMIT

Një komponent i rëndësishëm i veprimtarisë së Komisionit Disiplinor është dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, në aspektin e rritjes së cilësisë së vendimmarrjes dhe performancës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë kuadër, në datë 1.11.2021, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është zhvilluar takimi i dytë koordinues mbi procedimet disiplinore të magjistratëve, profili gjyqtar dhe prokuror, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë si, Këshilli i Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, Kolegji i Posaçëm të Apelit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si dhe përfaqësues të Misionit EURALIUS V etj.

Në fokus të këtij takimi, si dhe të takimeve të tjera të zhvilluara më parë, ka qenë përcaktimi i modaliteteve të shkëmbimit të informacionit me qëllim zbatimin e praktikave më të mira, bashkëpunimi në lidhje me propozimet për ndryshime ligjore, si dhe aplikimi i një qasjeje të unifikuar në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të reja ligjore, në kuadër të procedimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë si dhe organet e rivlerësimit kalimtar.

V. PËRFUNDIMET

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Komisioni Disiplinor si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor ka treguar përgjegjshmëri dhe kujdes në zbatueshmërinë në praktikë, të kuadrit ligjor për procedurat disiplinore, duke synuar objektivat si më poshtë:

- Aplikimin e praktikave më të mira dhe standardeve më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me procedimet disiplinore të filluara ndaj gjyqtarëve;
- Respektimin e pavarësisë së gjyqtarëve në ushtrimin e funksioneve gjyqësore;
- Garantimin e seancave dëgjimore publike në zbatim të parimit të një procesi të rregullt ligjor dhe parimit të drejtësisë së hapur;
- Garantimin e barazisë së armëve, duke respektuar në nivelin më të lartë të mundshëm të drejtat procedurale të subjekteve të procedimit, dhe në veçanti ato të parashikuara në ligj për magjistratin;
- Garantimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, jo vetëm në të qenit por dhe të dukjes si i tillë;
- Përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke marrë mendime dhe sugjerime nga të gjithë grupet e interesit, qoftë me anë të takimeve apo gjatë trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për procedimet disiplinore.

